

POLITIKA DHE OBJEKTIVAT E CILËSISË.**Politika e Cilësisë**

Trupa Çertifikuese TCPE, është e angazhuar për implementimin cilësor të programit të certifikimit të personit, për të gjithë klientët në përputhje me procedurat tona të miratuara.

Trupa Çertifikuese TCPE është e përkushtuar të sigurojë:

- a) I gjithë personeli shmang çdo përfshirje në çdo aktivitet që do të zvogëlonte besimin në kompetencën, paanshmërinë, gjykimin ose integritetin operacional të certifikimit.
- b) Menaxhmenti dhe i gjithë personeli janë të lirë nga çdo presion dhe ndikim i panevojshëm i brendshëm dhe i jashtëm komercial, financiar dhe të tjera që mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e vlerësimeve ose certifikimeve të tyre.
- c) Sigurimi i materialeve të përditësuara të ekzaminimit dhe në kohën e duhur, duke përdorur të dhëna nga ekspertiza jonë dhe palët e tjera të interesuara.
- d) Aplikojmë një proces transparent, të përcaktuar, i cili lejon verifikimin e vazhdueshëm të performancës në dobi të klientëve tanë.
- e) Pajtueshmëria me kërkesat e Standardit ISO/IEC 17024:2012 - (Vlerësimi i konformitetit- Kërkesat e përgjithshme për organet që operojnë certifikimin e personave).
- f) Zbaton përmirësim të vazhdueshëm në fushën e marrëdhënieve me klientët dhe tregut të nevojshëm

Deklarata jonë e Politikës së Cilësisë do të rishikohet gjatë takimit të Rishikimit të Menaxhmentit dhe do të lëshohet nën autoritetin e Menaxhmentit të Lartë.

Ne e konsiderojmë kompetencën dhe përgjegjësinë e stafit dhe palëve të tjera, si një nga aspektet kryesore për kënaqësinë e pjesëmarrësve dhe klientëve tanë. Ky është komponenti kryesor për cilësi të lartë të shërbimeve tona dhe suksesin e biznesit tonë.

3.2 Objektivi i cilësisë

- a) Të arrimë në 5000 persona të certifikuar në pesë (5) vjet
- b) Për të arritur në mbi 80% kënaqësinë e klientit
- c) Të përmbushim 100%, të kërkesave ligjore dhe të tjera
- d) Të arrihet zero ankesa nga palët e tjera

Tirane, e 09.05.2023

Administrator TCPE shpk

Xhevdet Kacani

